



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

DEKRIMINALIZIMI I POLITIKËS NË KOSOVË



*PROJEKTI "RRITJA E PJESËMARRJES QYTETARE NË PROCESET ZGJEDHORE NË KOSOVË"
NË KUADËR TË KOALICIONIT PËR INTEGRITET ZGJEDHOR (KIZ)*

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Tetor 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Gjithçka fillon me financa	7
3. Mosdallimi i Krimit prej Politikës	8
4. Krimi dhe Politika në Kosovë.....	11
5. Analizë krahasuese e legjislacionit për dekriminalizim.....	14
6. Partitë “pro” dekrimanilizimit me deklarata, kundër largimit “praktik” të të akuzuarve	15
7. Drejt zgjidhjes së problemit	18
a) Kufizimi përmes legjislacionit.....	18
b) Përjashtimi institucional.....	19

1. Hyrje

Sundimi i ligjit vazhdon të mbetet hallka më e dobët në zinxhirin e shtetndërtimit dhe qeverisjes në Kosovë. Institucionet përkatëse, e sidomos prokuroria e gjyqësori, përballen me probleme sistematike e të përsëritshme, një prej të cilave vazhdon të mbetet ndërhyrja politike. Dhe përkundër gjithë problemeve të sistemit të drejtësisë, pra duke marrë për bazë veç ato pak raste që ky sistem i trajton, fare lehtë krijohet përshtypja se krimi dhe politika bashkëjetojnë në Kosovë. Rastet kur zyrtarët e lartë të shtetit, ditën e punës e fillojnë në gjykatë, në cilësinë e të pandehurit, përpara se të vazhdojnë të qeverisin me vendin, nuk janë të rralla.

Një kësi rasti është Valdrin Lluka, aktualisht Ministër për Zhvillim Ekonomik. Më 27 tetor 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë kundër Valdrin Llukës, duke dyshuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), njëkohësisht edhe Kryeshef i Agjencisë për Promovim të Investimeve, më 23 mars 2014, kishte filluar procedurat për zotimin e mjeteve në vlerë prej 20 mijë euro për Organizatën Jo-Qeveritare (OJQ) “Jakov Innovation Center”, në të cilën OJQ kishte qenë vetë themelues. E akuzuar sipas kësaj aktakuze ishte edhe Sekretarja e Përgjithshme e MTI-së, Eliana Naka, e cila më 2 qershor 2014, kishte marrë vendim që mjetet prej 20 mijë eurove, t’i ndahen si mbështetje financiare OJQ-së “Jakov Inovation Center”, ku ajo vetë kishte qenë drejtore e bordit. Më 23 korrik 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë e shpalli të pafajshëm Valdrin Llukën, i cili në këtë kohë veçse ishte Ministër për Zhvillim Ekonomik.¹ Sipas aktgjykimit të shpallur nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Hamdi Ibrahim, nuk është provuar se Lluka ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohej. Ndërsa, ish-sekretarja e përgjithshme e MTI-së, Eljana Naka, u shpall fajtores dhe u dënua me 7 mijë euro gjobë.

Prej tetorit të vitit 2016, kur ndaj tij ishte ngritur aktakuza, e deri në korrik 2018 kur u shpall i pafajshëm, Valdrin Lluka vazhdoi punën e tij. Në shtator 2017, ai u emërua Ministër gjatë kohës sa ende po i vazhdonte gjykimi. Që atëherë, pra si ministër, ai morri pjesë në nëntë seanca gjyqësore, në Gjykatën Themelore në Prishtinë.² Gjatë kësaj kohe, sa ishte i akuzuar për korrupsion dhe konflikt interesi, më 20 dhjetor 2017, Valdrin Lluka mori pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes komerciale që Qeveria e Kosovës e lidhi me kompaninë amerikane Contour Global, për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”, projekt ky, që sipas kësaj marrëveshjeje, do të kushtojë 1.3 miliard euro.³

Valdrin Lluka nuk ishte as ministri i parë, e as i vetmi, të ketë punë me gjyqësorin përderisa ishte në ekzekutiv. Ministra, zëvendësministra, kryetarë komunash e deputetë të vendit, vazhdojnë të kryejnë funksione shtetërore e politike përderisa mbeten të hetuar apo të akuzuar për abuzim dhe korrupsion. Më 10 prill 2018, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë ndaj ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, duke e ngarkuar me dy vepra penale, atë të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe të përvetësimit në detyrë. Gjykata Themelore

¹ “Shpallja e aktgjykimit në rastin e Ministrit Valdrin Lluka dhe Eljana Naka”. www.betimiperdrejtesi.com (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/valdrin-lluka-lirohet-nga-akuza-per-konflikt-interesi/>)

² Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin Valdrin Lluka nga BetimiperDrejtisi. www.betimiperdrejtesi.com (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/?s=valdrin+lluka>)

³ “Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”. Evropa e Lirë. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/kontrata-per-ndertimin-e-termocentralit-kosova-e-re-/28928811.html>)

e Gjakovës e ka konfirmuar aktakuzën sa i përket veprës penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, derisa e ka hudhur poshtë aktakuzën për veprën penale “përvetësimi në detyrë”. Në aktvendimin të cilin e ka siguruar “Betimi për Drejtësi” thuhet se sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ndaj të akuzuarit Pal Lekaj, provat që i janë bashkangjitur aktakuzës nga ana e prokurorisë janë të pranueshme dhe qëndrueshmëria e tyre do të vërtetohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Dhe përderisa procesi gjyqësor ndaj tij vazhdon, Lekaj është duke ushtruar funksionin e Ministrit të Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës, ku menaxhon një buxhet prej më shumë se 65 milionë euro.⁴ Thirrjet e organizatave të shoqërisë civile për dorëheqjen e tij, si zakonisht, janë injoruar nga qeveria.

Këto dy raste, e ilustrjnë më së miri gjendjen e kastës aktuale politike në Kosovë, e cila në një mënyrë apo tjetër, bashkëjeton me krimin. Niveli i bashkëveprimit politik dhe atij të nëntokës, më së miri është parë gjatë publikimit të përgjimeve të aferave politike që publiku i njej me emrin ‘Pronto’. Në një seri audio-incizimesh të botuara në media, zyrtarë të lartë të shtetit, dëgjohen duke ‘kurdisur’ punët e shtetit, duke marrë vendime të jashtëligjshme për emërimë në pozita publike. Më 6 prill 2018, PSRK ngriti aktakuzë në rastin e aferës “Pronto”. Në mesin e 11 të akuzuarve janë edhe ish-shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, ministri aktual i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, deputeti aktual i PDK-së, Zenun Pajaziti, ish-kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Nijazi Kryeziu, ish-shefja e Njësisë për furnizim në Ministrinë e Shëndetësisë, Arbenita Pajaziti, ish-sekretari i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ilhami Gashi, ish-zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fatmir Shurdhaj, ish-këshilltari politik në MPB, Sedat Gashi, etj. Këta persona akuzohen për kryerjen e veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”, nga neni 193 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prej të cilave disa prej veprave kanë mbetur në tentativë.

Sipas aktakuzës, të pandehurit kanë keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare duke bashkëpunuar në mes vete për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave, të cilët kanë konkurruar në funksione të rëndësishme, siç janë: drejtor për Ndërmarrjet publike qendrore, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kryeshef i Agjencisë për Produkte Medicinale dhe Koordinator i Qendrës së Regjistrimit Civil në Komunën e Klinës, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.⁵

Shqyrtimi fillestar në rastin Pronto i caktuar më 1 tetor 2018, ishte shtyrë për arsye se ish-shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, ministri aktual i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, Besim Beqaj, ish-shefi tjetër i grupit parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, nuk u paraqitën në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kur edhe ishte caktuar të fillonte gjykimi ndaj tyre.

Prezent në gjykatë nuk ishin as katër të akuzuarit tjerë, Arbenita Pajaziti, Ilhami Gashi, Nijazi Kryeziu e Fatmir Shurdhaj. Gjykatësi i rastit, Shashivar Hoti bëri të ditur se mbrojtësi i të

⁴ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. (Shih linkun <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>)

⁵ “Afera “Pronto”, Prokuroria Speciale ngritë aktakuzë ndaj Adem Grabovcit, Zenun Pajazitit, Besim Beqajt dhe të tjerëve”. www.betimiperdrejtesi.com (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/afere-pronto-prokuroria-speciale-ngrite-aktakuze-ndaj-adem-grabovcit-zenun-pajazitit-besim-beqajt-dhe-te-tjereve/>)

akuzuarit Beqaj, avokati Besnik Berisha paraprkasht ka kërkuar shtyrjen e seancës me arsyetimin se klienti i tij ka pasur të caktuar më herët një agjendë tjetër.⁶

Bazuar në raste si këto, organizata prestigjioze Freedom House në raportin e përvjetshëm Nations in Transit vuri në pah se pushteti politik në Kosovë mbetet joformal, se vendimet merren në bare e kafiteri nga qarqet e fuqishme të partive politike dhe se institucionet e shtetit janë aty veç për të legjitimuar vendimet që ata marrin (Gashi, 2016). Sipas të njëjtit raport, informaliteti i pushtetit politik mbetet njëri nga problemet kyçe të Kosovës në konsolidimin e një sistemi demokratik. Instituti i Kosovës për Drejtësi gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore në çështje penale në të gjitha gjykatat e Kosovës, ka identifikuar numër të madh të rasteve kur të akuzuar për vepra penale të korrupsionit apo vepra tjera penale janë deputetë të Kuvendit të Kosovës, ministra, kryetar komunash, anëtar të kuvendeve komunale dhe persona tjerë të emëruar politik apo të zgjedhur nga vota e popullit. Karakteristikë e këtyre rasteve përbën fakti se numër i madh i këtyre zyrtarëve të lartë publik, një pjesë të ditës së tyre e kalojnë nëpër salla të gjykimeve, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale ku dominojnë veprat penale të korrupsionit, përderisa pjesën tjetër të kohës ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre publike.

Kriminalizimi i skenës politike në Kosovë është bërë një çështje brengosëse në Kosovë, veçanarisht që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, duke u shndërruar në një ‘standard’ të qeverisjes. Institucionet më të larta të shtetit si Kuvendi e Qeveria, por edhe pushteti lokal nëpër komuna, jo rrallë udhëhiqen nga persona me të kaluar kriminale apo që kanë probleme me ligjin. Anëtarët e qeverisë dhe qeverisja nga persona me të kaluar kriminale apo që kanë probleme me ligjin padyshim se ulin kredibilitetin dhe legjitimitetin në raport me qytetarët dhe cenojnë rëndë vlerat dhe parimet të cilat i promovon Kushtetuta e Kosovës.

Nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe kabineti qeveritar pritet që të përfaqësojnë interesat dhe aspiratat e qytetarëve të Kosovës. Në një shoqëri demokratike ku zbatohen parimet minimale të demokracisë dhe qeverisjes së mirë, këta përfaqësues duhet të jenë të ndershëm, llogaridhënës dhe të përçojnë besim dhe siguri tek publiku. Duke u nisur nga ky parim, IKD në këtë studim e shtjellon problematikën e kriminalizimit të politikës. Qëllimi i studimit është që të vë në pah thellësinë dhe kompleksitetin e problemit, duke kornizuar disa rekomandime konkrete. Të dhënat kryesore për këtë studim janë grumbulluar nga aktivitetet e përditshme të IKD-së që përfshijnë monitorimin e institucioneve të sundimit të ligjit, raportimin investigativ dhe hulumtimin ligjor e atë të politikave publike. Pos këtyre, kemi zhvilluar edhe dhjetë intervista kualitative me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të partive politike. Në anën tjetër, kemi marrë për bazë gjetjet dhe rekomandimet e studimeve të mëhershme të organizatave të shoqërisë civile, si dhe aktivitetet e tyre. Këto të dhëna i kemi interpretuar me një qasje pragmatike përmes logjikës abduktive, duke u munduar që të ndërtojmë një kornizë që e vizaton një pamje të komplikuar të ndërlikshmërisë së krimit me politikën dhe lë hapësirë për të nxjerrë rekomandime konkrete.

⁶ “Mungojnë Adem Grabovci, Besim Beqaj e pesë të tjerë, shtyhet shqyrtimi fillestar në rastin “Pronto”. www.betimiperdrejtesi.com (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-shtate-te-akuzuar-shtyhet-shqyrtimi-fillestar-ne-rastin-pronto/>)

2. Gjithçka fillon me financa

Nyja kryesorë në bashkëjetesën e politikës me krimin, jo veç në Kosovë, por në mbarë botën, mbetet financimi i partive politike. Grupe të fuqishme të interesit, shpesh të ndërlidhura me krimin, përdorin kornizën e fushatave zgjedhore për të mbështetur kandidatë politikë, me qëllim që të njëjtit të ‘kthejnë favoret’ sapo të marrin pushtetin. Edhe shoqëritë më të zhvilluara, si p.sh. SHBA-ja, vazhdimisht diskutojnë për masat parandaluese të ndërveprimit të krimit me politikën.

Në Kosovë, organizata të shoqërisë civile kanë theksuar në vazhdimësi problemet me transparencën rreth financimit të partive politike, ku kritikë i është bërë legjislacionit të mangët, zbatueshmërisë jo të mirë të ligjit, mungesën e masave sanksionuese ndaj partive, etj. Në studimet e mëhershme, IKD ka theksuar që financimi i partive politike dhe shpenzimi i financave sidomos për fushata zgjedhore vazhdimisht ka qenë problematike në Kosovë, sepse mungon transparenca në financimin dhe raportimin e financave të tyre.⁷ Qëndrimin e njëjtë e ndajnë edhe organizata tjera të shoqërisë civile, institute kërkimore e qendra të avokimit.⁸

Sipas Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), partitë politike vazhdojnë të mos zbatojnë ligjin kur është fjala tek deklarimi i financave të tyre sepse asnjëherë nuk kanë treguar vullnet për të bërë publike raportet e tyre financiare, përfshirë të ardhurat, kontributet, burimet e financimit, pasuritë, detyrimet, kapitalin dhe shpenzimet në mënyrë të drejtë.⁹ Organizata ÇOHU ka gjetur se “dy burimet kryesore të financave të partive politike vijnë nga buxheti publik dhe nga donatorë të jashtëm ose në formë të parave kesh ose në atë të kontributeve në mallra dhe shërbime”. Sipas gjetjeve “rreth 220 milionë euro i kanë përfitur financuesit e partive politike nga tenderët publikë përgjatë një periudhe kohore gusht 2007 - maj 2014”.¹⁰

Tutje, në bazë të intervistimeve, ÇOHU ka gjetur se disa kompani që direkt janë marrë me organizim fushatash ka dal se në trekëndëshin politikë-kompani marketingu-biznese që konkurrojnë në tenderë publik, është ndërtuar një strategji për të fshehur financimin e fushatave por edhe të vet Partive Politike.¹¹ Gjetjet e përbashkëta nga OJQ-të në Kosovë tregojnë që përgjegjësia për zbatimin e kornizës ligjore duhet të shtrihet në të gjitha nivelet - me organet përkatëse të mbikëqyrjes, organin legjislativ, partitë politike dhe kandidatët potencial për zgjedhje.

⁷ “Të hetohen partitë politike”; www.kli-ks.org; 16 gusht 2013. (Shih linkun <https://kli-ks.org/te-hetohen-financat-e-partive/>)

⁸ ÇOHU, Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Iniciativa për Progres (INPO), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Instituti KIPRED, D4D, Lëvizja FOL, Democracy Plus, etj

⁹ “Nuk ka Vullnet Politik për Transparencë në Financimin e Partive Politike” - (Shih linkun <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/nuk-ka-vullnet-politik-per-transparence-ne-financimin-e-partive-politike-2/>)

¹⁰ “Politika e Parasë” – (Shih linkun <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Politika-e-parase-71>)

¹¹ “Mosdeklarimi i financave rezulton me politikë klienteliste”. (Shih linkun <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Mosdeklarimi-i-financave-rezulton-me-politike-klienteliste-144>)

Rekomandimet e përbashkëta nga gjetjet e përbashkëta janë si në vijim:

- Rishqyrtimi i legjislacionit me theks të veçantë në definimin e plotë të një mekanizmi institucional që do të merrej me mbikëqyrjen e zbatimit të tij¹²;
- Institucionet mbikëqyrëse duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të vendosur sanksione për shkelje të atyre rregullave në lidhje me raportimin dhe publikimin e financave të partive politike;
- Donacionet private për partitë duhet të lejohen me kusht që të mos ketë ndonjë konflikt të interesit dhe të kufizohen¹³;
- Përpos dispozitave ndëshkimore të paraparë me ligj, partitë të cilat nuk e zbatojnë ligjin duhet tu merret e drejta për të garuar në zgjedhje;
- Partitë politike të bëjnë publike bizneset që i financojnë;
- Raporte individuale të shpenzimeve gjatë fushatës¹⁴;
- Monitorimi i donacioneve të partive politike në mënyrë që të verifikohen nëse donatorët e ndryshëm kanë bërë shkelje ligjore siç p.sh.: kanë marrëdhënie kontraktuale me qeverinë dhe institucionet publike në kohën kur kanë dhënë donacionin apo brenda kohës që ligji e parasheh si shkelje¹⁵;
- Të publikohen në uebsite Financat e Partive Politike;
- Kontrolli i brendshëm i financave në parti dhe raportimi i detajuar tek anëtarësia.¹⁶

Financimi i partive politike është çështja bazë, me prioritet të plotë, kur vjen puna te kriminalizimi i politikës. Fuqizimi i përhershëm dhe i vazhdueshëm i bazës ligjore që rregullon këtë fushë është prioritet i plotë i shoqërive më të zhvilluara dhe duhet të jetë prioritet absolut i shoqërive në zhvillim. Së këtijmi, çështja e financave të partive politike në Kosovë duhet të konsiderohet veç si pjesë formale e problemit, pjesë e cila është identifikuar mirë. Siç do elaborojmë në kaptinat në vijim, pjesët joformale tregojnë natyrën më të thellë të rrënjëve të problemit të kriminalizimit të politikës.

3. Mosdallimi i Krimit prej Politikës

Studimet në shkencë sociale tregojnë se krimi dhe politika nuk bashkëdyzohen veç tek financat e partive politike; ndërlihdshmëria e politikës me krimin është e shumëfishtë, shumëdimensionale dhe më rrënjësore sesa që zakonisht perceptohet. Sociologu Stanley Cohen nënvizon rrezikun e mosdallimit të dhunës politike prej asaj kriminale, duke përfunduar se për shumë vende, e sidomos ato në tranzicion, e gjithë perspektiva për konsolidimin e demokracisë varet pikërisht

¹² “Përsiatja e Dështuar: Financimi i partive politike në Kosovë”. (Shih linkun http://cohu.org/repository/docs/Persiatja_e_Deshtuar_ALB-FINAL-Print-Bleed-v1_175837.pdf, dhjetor 2016)

¹³ ¹³ “Nuk ka Vullnet Politik për Transparencë në Financimin e Partive Politike” - (Shih linkun <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/nuk-ka-vullnet-politik-per-transparence-ne-financimin-e-partive-politike-2/>)

¹⁴ Po aty. 5

¹⁵ Po aty. 5

¹⁶ “Financimi i partive Politike” – (Shih linkun <http://inpo-ks.org/finacimi-i-partive-politike/>)

nga aftësitë e shoqërive për të dalluar krimin prej politikës.¹⁷ Studimet e mëpasshme vënë në pah se përdorimi në vendet e zhvilluara përzierja e krimit me politikën mund ta përcaktojë nuancën e demokracisë, në vendet në tranzicion një bashkëdyzim i tillë e përcakton edhe vetë ekzistencën e demokracisë.

Si vend në tranzicion, Kosova përballlet me një sërë problemesh të vazhdueshme, që e komplikojnë kontekstin e operimit të krimit me politikën. Këtu, pikë së pari hyn trashëgimia nga e kaluara historike e sociale, qoftë prej periudhës së Jugosllavisë, represionit dhe luftës së armatosur, qoftë prej asaj të pasluftës dhe administrimit ndërkombëtar.¹⁸ Duke marrë për bazë teorinë institucionale, sipas të cilës sjellja e institucioneve të një shoqërie varet nga trajektorja e sjelljeve në të kaluarën, problemi i demarkimit të politikës nga krimi në Kosovë bëhet më evident.¹⁹ Përgjatë pushteteve represive në Kosovë, e mbase edhe përgjatë kohës së zgjidhjes së statusit të Kosovës nën administrimin ndërkombëtar, të qenit politik në shumë aspekte nënkuptonte të qenit i paligjshëm. Së këtëjmi, dallimi mes pushtetit politik dhe pushtetit kriminal bëhet i vështirë. Kur në këtë kontekst social ndodhë që politikanët të fillojnë ditën si të akuzuar në gjykatë dhe ta vazhdojnë duke qeverisur vendin, problemi i kriminalizimit të politikës bëhet dominant.

Demokracia si sistem i vlerave dhe organizimit politik nuk varet veç nga parimi i sundimit të shumicës, gjegjësisht zgjedhjeve të lira, dhe ndarjes së pushteteve, gjegjësisht sundimit të ligjit, siç perceptohet zakonisht. Sfera publike, përmes së cilës qytetarët mbahen drejtpërdrejt të angazhuar në jetën politike, është po aq e rëndësishme në funksionimin e demokracisë. Kjo sidomos meqë përmes sferës publike diskutohen e përcaktohen vlerat e një shoqërie, duke përfshirë këtu edhe kodin e saj etik.

Në demokracitë e konsoliduara, sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për të dalluar krimin prej politikës. Në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike që i përcakton shoqëria. Kësisoj, secili zyrtari që hetohet për krime, publiku i kërkon automatikisht dorëheqjen nga përgjegjësitë publike. Kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodhë që dorëheqja të kërkohej; zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëhiqen menjëherë, me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin. Ani pse kodi etik në këtë rast nuk e garanton një shkoqitje absolute të politikës prej krimit, të paktën e krijon përshtypjen e funksionimit të sistemit politik e shoqëror.

Në Kosovë, siç e kemi përshkruar në hyrje të këtij studimi, ministra, deputetë e kryetarë komunash vazhdojnë të qeverisin edhe kur ndaj tyre të kenë përfunduar hetimet. Qeverisja e njerëzve të cilët duhet të ndajnë orarin e punës për të marrë pjesë në procedura gjyqësore kundër tyre nuk lë veç hije të zezë në kuptimin etik të fjalës, por merr përmasa tejet praktike.

¹⁷ Cohen, S. (1996) *Crime and Politics: Spot the Difference*, The British Journal of Sociology, Vol. 47, No.1, pp.1-23.

¹⁸ Linz, J. dhe Stepan, A. (1996) *Problems of Democratic Transition and Consolidation*. Baltimore: John Hopkins University Press.

¹⁹ Peters, G. (1999) *Institutional Theory in Political Science: The New Institutionalism*. London: Pinter.

Në mungesë të një kodi funksional të etikës, shoqëritë në tranzicion si Kosova, tentojnë që krimin ta ndajnë prej politikës përmes proceseve rregulluese, qoftë përmes legjislacionit parandalues, qoftë përmes masave ndëshkuese institucionale.

Në një studim të bërë rishtaz nga Westminster Foundation for Democracy, janë elaboruar tri mjete të cilat shtetet e ndryshme nëpër botë i përdorin për të ruajtur kufirin mes krimit dhe politikës. Në të, kategorizohen tri lloje veprimesh që shoqëritë mund të ndërmarrin:

- 1) parandalimin e ndërlidhjes së politikës me krimin përmes ligjeve,
- 2) përjashtimin e krimit nga politika përmes rregullave të institucioneve politike dhe
- 3) ruajtjen e politikës nga krimi përmes rregullave të partive politike, qofshin ato parandaluese apo përjashtuese.²⁰

Gjatë hartimit të kornizës ligjore, shtetet mund të kufizojnë të drejtën e qytetarëve për të garuar për një pozitë publike. Kësisoj, p.sh., shoqëri të ndryshme nuk lejojnë garimin në zgjedhje të personave që kanë të kaluar kriminale. Problemi tek parandalimi përmes ligjeve si zgjidhje, megjithatë, qëndron në faktin se parimi kryesor i ligjërjes duhet të jetë mosdiskriminimi.²¹ Kësisoj, këtu duhet pasur parasysh të paktën dy aspekte, atë të konventave ndërkombëtare, të cilat Kosova i aplikon drejtpërdrejt e të cilat u japin të drejta qytetarëve, si dhe atë të prezumimit të pafajësisë, ku personat e dyshuar apo të përfshirë në krim kundër të cilëve nuk ka vendime gjyqësore, nuk mund të diskriminohen duke u diskualifikuar nga gara politike. Shtetet si Britania, Spanja e Australia, në nivele të ndryshme e përcaktojnë mënyrën dhe afatin e diskualifikimeve të tilla, ndërsa, veprat penale për të cilat zakonisht ndodhin diskualifikimet janë krimet e lidhura me zgjedhjet, lidhur me etikën (si mashtrimi, veprat penale seksuale, etj.) krimet kundër shtetit (tradhtia, aktet terroriste, etj.) si dhe veprat penale të bëra me paramendim.

Por parandalimeve përmes ligjeve, një mënyrë tjetër si shtetet e rregullojnë demarkimin e krimit prej politikës është përmes rregullave institucionale. Institucionet politike, si qeveritë apo parlamentet, parashohin kode të detajizuara të sjelljes për zyrtarët e tyre, duke u siguruar që në raste të përzjerjes në afëra kriminale, të njëjtit t'i përjashtojnë.²² Dhe, një hap i tretë i identifikuar në të njëjtin studim, është ai i rregullimit të problemit përmes partive politike. Në fakt, në të shumtën e rasteve, janë partitë politike ato që sigurohen se pjesëtarët e tyre i respektojnë kodet etike, pos atyre ligjore, duke u siguruar kështu ta ndajnë krimin prej politikës. Nga vendet në tranzicion, p.sh., Bashkimi i Forcave Demokratike në Bullgari, përmes statutit, përjashton mundësinë të anëtarësimit të qytetarëve që kanë bërë ndonjë veprim kriminal apo politik kundër popullit apo shtetit bullgar. Në Ganë, Partia e Re Patriotike, sipas aktit të saj themelues, parashih një komision verifikimi për të gjithë kandidatët që garojnë për pozita publike.²³ Partitë politike në vendet tjera, e sidomos ato që krijohen rishtas, gjithnjë e më shumë po mundohen që të kenë provizione të tilla parandaluese nëpër dokumentet strategjike.

²⁰ Westminster Foundation for Democracy (2018) *Transformimi i Qeverisjes Politike në Kosove: Dekriminalizimi i Qeverisjes Politike*. Prishtine, 2018.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

²³ Po aty.

4. Krimi dhe Politika në Kosovë

Kushtetuta e Kosovës përcakton se çdo shtetas i Republikës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Përjashtimisht, neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ka përcaktuar kategoritë e personave, të cilët janë të papërshtatshëm për tu certifikuar si kandidatë për zgjedhje të përgjigjshme apo lokale. Ndër të tjera ky ligj ua pamundëson kategorive të këtyre personave për të garuar në zgjedhje të përgjithshme apo lokale:

- a) Personave që janë duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
- b) Personave nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit;
- c) Personave të cilëve një e drejtë e tillë iu është kufizuar me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e KZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
- d) Personave të cilëve kjo e drejtë iu është hequr e drejta për të qenë kandidat me anë të vendimit të gjykatës, dhe
- e) Personave të cilët janë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Në plan të gjerë, debati shtrohet mes të drejtave fundamentale të njeriut të cilat u garantojnë edhe personave në procedurë gjyqësore që të zgjedhin dhe të zgjedhen, në njërin anë, si dhe vlerave të shoqërisë që të qeveriset nga njerëz me duar të pastra në anën tjetër. Në Kosovë, kryesisht duke u bazuar në pjesën e parë të argumentit, vazhdimisht kemi licensuar kandidatë në zgjedhje, të cilët jo domosdoshmërisht i kanë pasur duart e pastra.

Për shembull, vitin e kaluar, pra me 2017, në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet lokale dhe ato për kryetarë të komunave. Gjatë këtij procesi zgjedhor, KQZ-ja ka vazhduar të certifikojë kandidatë që kishin të kaluar të vërtetuar kriminale. Më 10 shtator 2017, IKD kishte reaguar ndaj KQZ-së lidhur me certifikimin e kandidatëve me të kaluar kriminale, respektivisht me dënime gjyqësore të formës së prerë, të cilët garojnë për asamblistë dhe Kryetar të Komunave në zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017. Në reagimin tonë, kishim vlerësuar se vendimi i KQZ-së për të certifikuar kandidatët me të kaluar kriminale në tri vitet e fundit, në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Kosovë paraqet skandal, duke ftuar Prokurorin e Shtetit të hetojë vendimmarrjen e KQZ-së. Baza për hetim është nënvizuar të jetë fakti se përkundër të dhënave zyrtare nga KGJK për kandidatët me të kaluar kriminale, KQZ kishte bërë certifikimin e tyre apo nuk kishte ndërmarrë veprime konform ligjit për të pastruar listat e kandidatëve për asamblistë apo Kryetar të komunave. Sipas të njëjtës bazë ligjore, pra sipas ligjit të vendit në Kosovë, këtyre kandidatëve do duhej mohuar e drejta për të kandiduar në zgjedhjet komunale të përcaktuara më 22 tetor 2017.

Ky vendim i KQZ-së kishte dëshmuar mungesën e vullnetit politik të partive politike, të cilat përmes përfaqësuesve të tyre përbëjnë trupën e KQZ-së për të respektuar kriteret ligjore, duke synuar futjen e kandidatëve me të kaluar kriminale në kundërshtim me ligjin.

Përbërja politike e KQZ-së nuk do të paraqiste kurrfarë problemi në shoqëritë demokratike. Përfaqësimi i forcave politike në bazë të një shablloni që përafërsisht pasqyron fuqinë e tyre politike është formulë që do duhej të prodhonte balanc politik. Në Kosovë, megjithatë, puna KQZ-së shpesh bëhet rob i këtij balanci politik, ku partitë politike gjejnë konsensus për të marrë vendime nga të cilat përfitojnë veç ato dhe jo domosdoshmërisht sistemi dhe shoqëria. Përbërja politike e KQZ-së, kësisoj, bën që mungesa e kodit etik të partive politike që do të rregullonte ndarjen e krimit dhe politikës pasqyrohet kryekëput edhe në këtë institucion. Kësisoj, institucioni kyç shtetëror që rregullon punën e partive politike dhe zgjedhjeve përballet me të njëjtën paaftësi për ta rregulluar ndarjen e politikës nga krimi.

Bazuar në të dhënat zyrtare që IKD kishte siguruar, nga mbi 7000 kandidatë për të cilët KQZ kishte kërkuar të dhëna për të kaluarën e tyre kriminale në Gjykatat Themelore të Republikës, mbi 600 kandidatë kanë pasur aktgjykime dënuese përfundimtare ose gjendeshin në procedura penale. IKD kishte kërkuar nga KQZ që në përputhje me legjislacionin pozitiv, të bëhet largimi i të gjithë kandidatëve për asamblistë dhe kandidatëve për Kryetar të Komunave që kanë aktgjykime dënuese përfundimtare për vepra penale.

Në këtë drejtim, IKD ka pranuar ankesa të kandidatëve, të cilët kontestonin saktësinë e të dhënave të KGJK-së, prandaj kishte kërkuar nga KGJK që të verifikojë të dhënat e vendimeve përfundimtare gjyqësore nga Gjykatat Themelore për të qenë të saktë dhe për të kufizuar të drejtat e kandidatëve me aktgjykime përfundimtare në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Kosovë.

Më 12 shtator 2017, KQZ duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kishte marr vendim për decertifikimin e të gjithë kandidatëve që kishin garuar për Kryetar të Komunave dhe asamble komunale për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017, që kishin aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Kosovës. Në mesin e atyre që iu mohua kjo e drejtë për të garuar për Kryetar komune ishte edhe deputeti i Nismës Zafir Berisha, që kishte kandiduar për kryetar të Prizrenit.

Ndaj vendimit të KQZ-së, kandidatët e decertifikuar kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, përfshirë kandidatin Zafir Berisha. Gjykata Supreme kishte miratuar ankesën e Zafir Berishës, kandidat nga subjekti politik “Nisma”, për kryetar të komunës së Prizrenit, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Si rrjedhim Gjykata Supreme kishte obliguar KQZ-në, të bëjë certifikimin e kandidatit në fjalë, për zgjedhjet lokale të 22 tetorit.

Sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr. 16/2017, të Gjykatës Supreme të datës 19 shtator 2017, askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë të gjykatës të shpallet fajtor dhe gjykata t’i ketë shqiptuar edhe dënim plotësues “heqjen e të drejtës për t’u zgjedhur”. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme po ashtu, kishte konstatuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, ku sipas interpretimit të kësaj gjykate kur në një anë kemi normën kushtetuese, e cila përcakton se e drejta për të garuar në zgjedhje mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor dhe në anën tjetër neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e

Përgjithshme parashih mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte pa vendim gjyqësor, mbizotëron Kushtetuta si akt më i lartë juridik.

Lidhur me vendimin e Gjykatës Supreme, kishte reaguar edhe Ambasada Amerikane në Kosovë. Sipas Ambasadës, ky vendim i KQZ-së zbaton urdhrat e Gjykatës Supreme për ricertifikimin e kandidatëve të diskualifikuar më parë, bazuar në Ligjin për Zgjedhjet. “E kuptojmë vendimin e KQZ-së për t’i kthyer të 89 kandidatët e diskualifikuar si kundërpërgjigje vendimit të Gjykatës. Megjithatë, na vjen keq që rezultati i këtij vendimi zhbën punën e shkëlqyeshme të KQZ-së dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për të zbatuar ndalesën e paraparë me Ligjin për Zgjedhje për moslejimin e kandidimit të kandidatëve të dënuar për vepër penale”, thuhet në letrën e Ambasadës Amerikane.

“Vazhdojmë të mbështesim frymën dhe qëllimin e asaj dispozite të Ligjit për Zgjedhje. Ftojme institucionet përkatëse shtetërore që të korrigjojnë çdo paqartësi ligjore lidhur me këtë dispozitë para ciklit të ardhshëm zgjedhor në Kosovë. Besojmë që votuesit kërkojnë kandidatë të panjollësuar nga krimi”.

Si rezultat i interpretimit të Gjykatës Supreme dhe paqartësisë ligjore, respektivisht Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme vetëm në zgjedhjet lokale të mbajtura më 22 tetor 2017, janë certifikuar dhe kanë kandiduar mbi 600 persona me të kaluar kriminale për kryetar komune apo asamble komunale.²⁴

Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2017 dhe 2018 ka punuar në ri shikimin e Kodit Penal të Kosovës, i cili ishte miratuar në Qeverinë e Kosovës më 13 prill 2018,²⁵ dhe i njëjti ende gjendet në Kuvendin e Kosovës për procedura të metutjeshmë.

Dispozitat e Projekt-Kodit Penal lidhur me kufizimin e të drejtës për t’u zgjedhur janë pothuajse të njëjtat dispozita të Kodit Penal që është aktualisht i zbatueshëm në Kosovë. Si Kodi Penal ashtu edhe Projekt Kodi Penal parashohin tre lloj dënimesh ndaj kryesve të veprave penale: dënimin kryesor, alternativ dhe plotësues. Dënimet plotësuese mund të shqiptohen së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.

Në kuadër të dënimeve plotësuese, është paraparë edhe heqja e të drejtës për t’u zgjedhur. Gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim. Përderisa, sipas Kodit Penal, ekzekutimi i dënimeve plotësuese fillon së bashku me ekzekutimin e dënimit kryesor ose të dënimit alternativ. Ekzekutimi i dënimit plotësues lidhur

²⁴ “IKD reagon ndaj shkeljes së ligjit nga KQZ, kërkon largimin e kandidatëve të certifikuar që kanë aktgjykime dënuese përfundimtare dhe fton Prokurorin e Shtetit të hetojë vendimmarrjen e KQZ-së”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 10 shtator 2017.

(Shih linkun <http://kli-ks.org/ikd-reagon-ndaj-shkeljes-se-ligjit-nga-kqz-kerkon-largimin-e-kandidateve-te-certifikuar-qe-kane-aktgjykime-denuese-perfundimtare-dhe-fton-prokurorin-e-shtetit-te-hetoje-vendimmarrjen-e-kqz-se/>)

²⁵ Projekt-Kodi Penal i Kosovës, i miratuar me 13 prill 2018 në Qeverinë e Kosovës. (Shih linkun <http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/04/PROJEKTKODI-PENAL-I-REPUBLIK%C3%8BS-S%C3%8B-KOSOV%C3%8BS.pdf>)

me heqjen e të drejtës për tu zgjedhur fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim dhe se gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, personi i dënuar nuk mund t'i gëzojë të drejtat e kufizuara nga dënimi plotësues.

5. Analizë krahasuese e legjislacionit për dekriminalizim

Hulutimi i IKD-së në legjilacionin e vendeve të ndryshme sa i përket dekriminalizimit tregon se praktikrat janë të ndryshme, duke vendosur kufizime përmes ligjeve specifike dhe përmes vendimeve gjyqësore.

Praktikat e ndalimit me ligj apo me vendim gjyqësor

Shteti	Me vendim gjykate për kufizimin e së drejtës për të kandiduar	Si rezultat i dënimit të shqiptuar nga Gjykata
Gjermania	Kur gjykata lëshon vendim për privimin e një personi nga e drejta e kandidimit për parlament ose për post publik.	Personat që humbasin të drejtën e votës për shkak të dënimit penal. Ata që humbin të drejtën e votimit, automatikisht konsiderohen si të diskualifikuar për të garuar për parlament
Britania e Madhe	Dhoma e Përfaqësuesëve ka autoritet për të përjashtuar anëtarët e Dhomës që nuk përmbushin rregullat e Dhomës, por kjo ka qenë një dukuri e rrallë kohë të fundit.	Personi i cili shpallet fajtor për veprë penale dhe dënohet (ose urdhërohet të burgoset) për më shumë se një vit, diskualifikohet nga mundësia e zgjedhjes në Dhomën e Përfaqësuesve
ShBA	Nuk ka ndalesë kushtetuese ose legjislative për personat e dënuar që të garojnë në zgjedhje për Kongres	Nenit 1, Seksioni 5 i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara, "secila dhomë mund të përcaktojë rregullat e punës, të dënojë anëtarët e saj për sjellje të çrregullt dhe, me pajtimin e dy të tretave, të përjashtojë ndonjë anëtar," duke i dhënë institucionit të drejtën për të vendosur sanksionet e veta deri në dënimin maksimal, atë të përjashtimit.
Estoni		Individi humb të drejtën e votimit dhe të kandidimit nëse është dënuar me burgim për krime të veçanta
Armeni		Individi humb të drejtën e votimit dhe të kandidimit nëse është dënuar me burgim për krime të veçanta
Turqi		Personi i dënuar me më shumë se një vit dhe për vepra të rënda nuk kanë të drejtë kandidimi
Maqedoni		Personat e dënuar mbi 6 muaj ose që janë duke vuajtur dënimin për krime të rënda nuk kanë të drejtë kandidimi në zgjedhje

Praktikat e përjashtimit institucional:

Shteti	
ShBA	Nenit 1, Seksioni 5 i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka përcaktuar se "secila dhomë mund të përcaktojë rregullat e punës, të dënojë anëtarët e saj për sjellje të çrregullt dhe, me pajtimin e dy të tretave, të përjashtojë ndonjë anëtar," duke i dhënë institucionit të drejtën për të vendosur sanksionet e veta deri në dënimin maksimal, atë të përjashtimit nga dhoma e përfaqësuesve apo senatit.
Bullgaria	Bashkimi i Forcave Demokratike (Bullgari) – Statuti i partisë bllokon anëtarësimin në parti shtetasve të përfshirë në ndonjë veprim kriminal apo politik kundër popullit ose shtetit të Bullgarisë, personalisht ose si anëtar i një partie totalitare.
Britania e Madhe	Partitë kryesore politike në Britani të Madhe kanë rregulla dhe politika për anëtarësim dhe kandidim. Për shembull, statuti i Partisë Laburiste i jep fuqi Komisionit Ekzekutiv Kombëtar për të ndërmarrë veprime kur një anëtar është dënuar për një krim, duke filluar nga pezullimi deri të përjashtimi nga partia.
Gjermania	Sipas Ligjit të Partive Politike, personat, të cilët përmes një vendimi gjyqësor janë privuar nga e drejta për të kandiduar në zgjedhje ose për të votuar, nuk lejohen të jenë anëtarë të një partie politike. Prandaj, ata humbasin të drejtën për të qenë kandidat të partisë.
Kenia	Sipas Aktit të Partive Politike të vitit 2011, rregullat dhe rregulloret e secilës parti politike duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, dhe moszbatimi i tyre paraqet bazë për çregjistrimin e partisë. Partia gjithashtu duhet të nënshkruajë Kodin e Mirësjelljes, i cili ndër të tjera ndalon partinë që të marr ryshfet, të ndikojë në mashtrime dhe në forma të tjera të korrupsionit.

6. Partitë “pro” dekriminalizimit me deklarata, kundër largimit “praktik” të të akuzuarve

Shtjellimet e ndërlihdjes së politikës me krimin dhe përvojat e zyrtarëve qeveritarë që paradite gjykohen për vepra penale të korrupsionit, ndërsa pasdite marrin pjesë në mbledhje të Qeverisë, në Kuvend të Kosovës, në Komuna, institucione e agjencione të pavarura për të qeverisur në të mirën e qytetarëve.

Derisa dhjetëra zyrtarë të lartë shtetërorë, si zëvendëskryeministra e ministra të qeverisë, deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe zyrtarë të tjerë, hetohen, akuzohen dhe gjykohen për vepra penale të korrupsionit, IKD ka hasur në vështirësi në sigurimin e shumë intervistave me përfaqësuesit e partive politike për të diskutuar për dekriminalizimin e politikës në Kosovë. Megjithatë, IKD ka intervistuar përfaqësuesit e të gjitha partive politike parlamentare, të cilët deklarohen pro dekriminalizimit të politikës, por që në fakt, shumica prej tyre, tash për tash, kanë përfaqësues të akuzuar për vepra të ndryshme penale të korrupsionit, përjashtojë përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët akuzohen për vepra jokurruptive, por që ndërlihdhen me veprimet e tyre të sferës penale në kuadër të aktivitetit të tyre politik.

Përfaqësuesit e partive politike parimisht pajtohen se duhet të ndodhë dekriminalizimi i politikës në Kosovë, por kanë qëndrime të ndryshme se si duhet t'i qasemi kësaj problematike. Për situatën aktuale, në të cilën ka një numër të madh të zyrtarëve të lartë shtetërorë me aktakuza e dënime, ata kanë vlerësime të ndryshme.

PDK²⁶, NISMA²⁷ dhe AAK²⁸ parimisht, vlerësojnë se pa pasur vendime përfundimtare gjyqësore, askush nuk duhet të paragjykohet dhe të pësoi për shkak të ngritjes së një aktakuze

²⁶ IKD intervistë me z. Elmi Reçica nga Partia Demokratike e Kosovës. Shtator 2018.

apo procedimit të një rasti gjyqësor. Thonë se duhet pasur kujdes ndaj të akuzuarëve, të cilët assesi nuk duhet të konsiderohen të fajshëm dhe të ndëshkohen. Në këtë drejtim, AAK thekson se ka ndikime politike në sistemin e drejtësisë, ku prokurorët kanë ngritur aktakuza të pabaza ndaj zyrtarëve të ndryshëm, të cilat janë rrëzuar nga gjykata. LDK²⁹ shprehet se nuk ka gatishmëri për tu ballafaquar me zyrtarët e pushtetit, siç i quajnë të kriminalizuar për shkak të aktakuzave që kanë për korrupsion. Lëvizja VV³⁰ vlerëson se qeverisja në Kosovë ka ndërtuar standard të qeverivjes përmes njerëzve të akuzuar për korrupsion. Duke ditur faktin se një numër i deputetëve të kësaj partie, kanë aktakuza për vepra penale jokorruptive, përfaqësuesit e VV-së theksojnë se duhet pasur kujdes me idenë e dekriminalizimit, duke bërë një dallim të madh në mes të idesë për të larguar nga skena të akuzuarit dhe dënuarit për vepra korruptive dhe jokorruptive. PSD³¹ konsideron se për të pasur ndryshime në drejtim të dekriminalizimit në Kosovë, duhet pasur ekzekutiv tjetër, i cili do të ndërmerre masa gjithpërfshirëse në të gjitha institucionet për përfshirje në një proces të vetingut. Kjo sipas tyre është zgjidhja e vetme për dekriminalizimin.

Përfaqësuesit e të gjitha këtyre partive politike theksojnë se në partitë e tyre kanë diskutuar për idenë e rregullimit të fushës së dekriminalizimit, për të cilën parimisht deklarohen se pajtohen të gjitha subjektet. PDK thotë se kjo është ide e kreut të kësaj partie, ndërsa VV tërheq vërejtjen për mënyrën se si tentohet të rregullohet dekriminalizimi, duke theksuar, sipas tyre, përndjekjen e aktivistëve të kësaj partie për aktivitete puro politike, përderisa në të njëjtën kohë, sistemi sipas tyre i kapur i drejtësisë nga pushteti aktual, amnistion veprimtaritë korruptive të pushtetarëve.

Përfaqësuesi i PDK-së thekson se qëndrimi i kësaj partie është se të gjithë anëtarët e partisë, të cilët janë në procedura gjyqësore dhe me vendime të plotfuqishme nuk mund të jenë pjesë e institucioneve. Megjithatë, një gjë e tillë tani nuk po respektohet sepse në Qeveri dhe Kuvend, ka deputetë të PDK-së, të cilët janë duke u gjykuar për vepra penale dhe të cilët nuk po preken fare. LDK insiston se gjatë kohës së qeverisjes Mustafa, kjo parti, ka ndërtuar një standard që njerëzit me aktakuza mos të jenë në qeverisje të institucioneve. Megjithatë, ka pasur deputetë të LDK-së të akuzuar për korrupsion, si rasti i Naser Osmanit, i cili nuk është tërhequr dhe partia nuk e ka prekur. Përderisa AAK thotë se kanë pasur raste kur kanë tërhequr zyrtarët që kanë pasur aktakuza, përfaqësuesi i NISMA-së thotë se do të marrin qëndrim si parti se si do të veprojnë në lidhje me këto raste. VV dhe PSD kërkojnë qartësim kur bëhet fjalë për personat e akuzuar, duke theksuar se për vepra korruptive duhet të përjashtohen, ndërsa për vepra politike mos të vlejë ky kriter.

Kur bëhet fjalë për të ndërmarr veprime për të larguar personat me integritet të kontestuar për shkak të aktakuzave apo dënimeve, PDK shprehet se partia dhe qeveria janë ato që duhet të vendosin. LDK vlerëson se partitë politike, në rrethanat aktuale, nuk kanë mundësi të largojnë individët që kanë probleme me aktakuza, prandaj konsideron se vetëm përmes ligjit mund të rregullohet një gjë e tillë. PSD, AAK dhe NISMA thonë se partia duhet të vendosë për largime

²⁷ IKD intervistë me z. Etem Arifi nga Nisma Socialdemokrate e Kosovës. Shtator 2018.

²⁸ IKD intervistë me z. Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Shtator 2018.

²⁹ IKD intervistë me z. Imet Rrahmani nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Shtator 2018.

³⁰ IKD intervistë me znj. Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje. Shtator 2018.

³¹ IKD intervistë me z. Frashër Krasniqi nga Partia Social Demokrate e Kosovës. Shtator 2018.

dhe se një diskutim i tillë ka ndodhë brenda partive. VV thonë se asnjëherë nuk do të largojnë përfaqësuesit e tyre me aktakuza, përderisa aktakuzat, sipas tyre janë përndjekje politike dhe për vepra penale që ndërlidhen me aktivitet politik.

IKD gjatë intervistimit të përfaqësuesve të partive politike, ka pyetur se në çfarë forme mendojnë partitë e tyre se duhet të bëhet dekriminalizimi i politikës dhe se a mund të rregullohet kjo përmes një Kodi të Mirësjelljes, i cili do duhej të shërbente për të gjitha partitë politike që ato mos të lejonin persona që kanë probleme me ligjin të jenë pjesë e listave zgjedhore apo edhe në kohën kur janë në ekzekutiv në momentin që përballen me akuza zyrtare të prokurorisë të largohen përkohësisht nga qeverisja. Në lidhje me këtë çështje, PDK vlerëson se duhet të ketë një një koordinim dhe qëndrim të përbashkët të të gjitha partive politike dhe sipas PDK-së kjo mund të arrihet pasi të gjitha partitë janë deklaruar publikisht se janë të interesuara ta rregullojnë çështjen e dekriminalizimit. Përfaqësuesi i LDK-së nuk beson se Kodi i Mirësjelljes mund të jetë zgjidhje për dekriminalizim të politikës. Një ndër arsytet që në Qeveri nuk mund të jetë një Kod i tillë zgjidhje, mbështetet në faktin se disa parti që futen në koalicion qeveritar e kanë të vështirë të bëjnë lëvizje me individë të fuqishëm të atyre partive, të cilët mbesin të paprekshëm. Në të njëjtën linjë, kanë qëndrim PSD, të cilët thonë se problemet e natyrës kriminale mund të rregullohen vetëm përmes ligjit e jo Kodit të Mirësjelljes, edhe pse në parim do ta preferonin një rregullim përmes Kodit. Për AAK dhe NISMA, partitë politike përmes statuteve do të mund ta rregullonin problematikën e dekriminalizimit, ndërsa një Kod i përbashkët, do të ishte zgjidhje për të gjithë spektrin e partive politike. VV insiston se pa pastrimin e sistemit të drejtësisë, nuk mund të paramendohet një zgjidhje funksionale për ta bërë dekriminalizimin e politikës.

Rregullimi ligjor për PDK-në mbetet opsioni më i qëlluar dhe për këtë thonë se Kryetari i kësaj partie ka shpalosur publikisht idenë e dekriminalizimit përmes ligjit. Ende thonë se janë duke ndërtuar qëndrim se si duhet të bëhet dekriminalizimi përmes ligjit, duke mos cenuar të drejtat dhe liritë e njeriut. LDK njëjtë vlerëson se ligji është zgjidhja e vetme, por nuk sheh zgjidhje të këtij problemi, pa ndryshuar Ligji për Zgjedhjet dhe rrjedhimisht pa nisur një reformë e thellë zgjedhore në Kosovë. NISMA thotë se përkrah rregullimin ligjor për dekriminalizim. AAK kërkon që rregullimi ligjor të jetë i saktë dhe mos të ketë dykuptimësi. VV dhe PSD deklarojnë se projektligji për dekriminalizim duhet analizuar mirë se çfarë synon të rregullojë dhe çfarë shtrirje do të ketë.

Një ndër problemet më kryesore në Kosovë, të cilën e kemi shtjelluar në këtë punim, mbetet financimi i dyshimtë i partive politike. Në këtë drejtim, PDK thonë se duhet pasur kujdes se si financohen partitë, duke hulumtuar mirë burimin e financimit, që mos të ketë asnjë lidhje kriminale. LDK thonë se transparencja e financimit të partive politike mbetet problem i madh në të gjitha shtetet. Sipas LDK-së financimet e dyshimta nga kompani me potencial të madh financiar, kanë krijuar monopole dhe kanë sjellë deri te kriminalizimi i politikës, për shkak se financuesit gjithmonë kërkojnë shërbime kthyese. VV thonë se ky subjekt vazhdon të mbetet subjekti më transparent në shpenzimet e financave dhe gjitha të hyrave tjera. VV përkrah rregullimin e ashpër ligjor për çështjen e financimit dhe shpenzimit të parave nga partitë politike. AAK dhe NISMA thonë se duhet të ketë zbatim të ligjit dhe auditime për partitë politike dhe

kandidatët e pavarur. PSD theksojnë se kjo çështje është e rregulluar me ligj por duhet vetëm zbatimi i ligjit.

Partitë politike brenda vetës përballen me probleme të shumta të demokracisë, ku shumë prej anëtarëve mbesin nën hijë, sidomos të liderëve të tyre. Fuqinë për ndryshime brenda partive, të gjithë deklarojnë se e kanë përmes organeve të tyre, por që në praktikë ka kritika të shumta se sa mund të jenë të efektshme.

7. Drejt zgjidhjes së problemit

Nevoja për dekriminalizimin e skenës politike është potencuar shpeshherë nga liderët politik dhe institucional, përfaqësuesit e shoqërisë civile, komuniteti ndërkombëtar dhe të tjerë. Për më tepër, ky problem vazhdimisht rishfaqet në publik para zgjedhjeve të përgjithshme ose lokale.³²

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova është ballafaquar me një qeverisje qoftë në nivelin qendror, lokal apo atë të administratës shtetërore me individë që kanë pasur problem me ligjin, që kanë ndikuar në mungesë besimi, kredibiliteti dhe integriteti qoftë në raport me qytetarët ashtu edhe me faktorin ndërkombëtar.

Qeverisja në një shtet demokratik duhet të garantojë dhe siguroj besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura, institucioneve të pavarura, administratës shtetërore dhe atyre të krijuara me ligj, përmes pengimit të zgjedhjes ose emërimit në këto institucione ose përjashtimit institucional përmes largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo kanë probleme me ligjin.

IKD duke u bazuar në kornizën ligjore në Kosovë, praktikën e ndërtuar nga Gjykata Supreme lidhur me heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur, praktikat dhe përvojat e shteteve të ndryshme, dhe duke marrë me theks të veçantë gjendjen e krijuar në skenën politike dhe administratën shtetërore dhe publike, propozon disa modele sesi mund t'i qaset Republika e Kosovës, pastrimit apo dekriminalizimit të skenës politike në Kosovë.

a) Kufizimi përmes legjislacionit

Kushtetuta e Kosovës në nenin 45 përcakton se çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Vendimi i Gjykatës Supreme, AA.-Uzh.nr. 16/2017, i datës 19 shtator 2017, ka përforcuar këtë garancë kushtetuese, duke përforcuar të drejtën e zgjedhjes dhe për të kufizuar këtë të drejtë vetëm në rastet kur kandidati dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe kur gjykata t'i shqipton edhe dënim plotësues "heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur".

³² *Transformimi i Qeverisjes Politike në Kosovë, Dekriminalizimi i Qeverisjes Politike*, Raport Krahasues, Westminster Foundation for Democracy, shkurt 2018.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme po ashtu, kishte konstatuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, ku sipas interpretimit të kësaj gjykate kur në një anë kemi normën kushtetuese, e cila përcakton se e drejta për të garuar në zgjedhje mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor dhe në anën tjetër neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte pa vendim gjyqësor, mbizotëron Kushtetuta si akt më i lartë juridik.

Në këtë drejtim, praktika gjyqësore e ndërtuar nga Gjykata Supreme, dispozitat ligjore lidhur me ndalimin legjislativ të përcaktuar qoftë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme por edhe më Kodin Penal të Kosovës, i konsideron si kundër kushtetuese dhe jo të zbatueshme.

Përveç kësaj, Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut përcakton kriteret kumulative për heqjen e së drejtës për t'u zgjedhur, e të cilat kriteret përfshijnë obligimin se duhet të parashihet me ligj, duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit, duhet të jetë i bazuar në dënim për veprë penale të rëndë dhe duhet të shqiptohet nga gjykata.³³

Në këto rrethana të krijuara, IKD konsideron ndalimi legjislativ i kufizimit të drejtës për t'u zgjedhur mund të rregullohet vetëm përmes ndryshimeve kushtetuese dhe duke marrë për bazë kriteret dhe praktikën e mira lidhur me çështjet zgjedhore dhe qeverisjes së mirë.

b) Përjashtimi institucional

Përjashtimi institucional qoftë përmes kufizimit të kandidimit apo largimit në postet ku janë emëruar të personave në institucionet e zgjedhura mund të bëhet përmes rregullave të brendshme mbi papërshtatshmërinë. Partitë politike përmes rregullave të brendshme duke miratuar Kode të Etikës do të kufizonin të drejtën e qytetarëve me të kaluar kriminale apo që janë të papërshtatshëm për të anëtarësuar në parti politike. Kodi i Etikës mund të ndërtonte praktika përmes së cilave partitë politike nuk mund të propozojnë në pozita udhëheqëse, në poste politike ose si kandidatë partiak persona të papërshtatëm dhe që kanë integritet të kontestuar.

Miratimi i Kodeve të Etikës do të kishte karakter obligativ, vet rregullues dhe përjashtues ndaj individëve që kanë probleme me ligjin. Kodet e Etikës mund të marrin për bazë dhe të përfshijnë parimet e ndërtuara nga Komisioni i Venecias dhe shtetet me përvojë të gjatë të demokracive parlamentare.

Përparësitë e përjashtimit të tillë institucional në praktikë kërkojnë vullnet politik të partive politike, dhe nuk paraqesin kërkesë për ndryshime kushtetuese dhe ligjore.

³³ Po aty.

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).